



Agjencia Kombëtare e
Kontrollit të Cannabis-it

BULETIN 02



BULETIN

PRILL - QERSHOR 2026

PËRMBAJTJA

- 01** Pjesëmarrje në Samitin Global Rregullator të Cannabis-it 2026
 - 02** Si duket EU-GMP në praktikë: Vizitë pranë PharmaRolly Holdings
 - 03** Çfarë mund të mësojë Shqipëria nga modeli italian
 - 04** Brenda fabrikës që prodhon *cannabis* mjekësor në Firenze
 - 05** Strategjia Kombëtare për Kontrollin e Drogave 2026–2030
 - 06** Vizitë në laboratorin OMMA dhe pjesëmarrje në CANNRA 2026
 - 07** Takim me EUDA: drejt standardeve europiane të raportimit
 - 08** Njihuni me stafin e Agjencisë
-

PJESËMARRJE NË SAMITIN GLOBAL RREGULLATOR TË CANNABIS-IT 2026 | LONDËR, 19 – 21 PRILL 2026

Në datat 19–21 prill 2026, Agjencia mori pjesë në “Global Cannabis Regulatory Summit 2026” në Londër, një platformë ndërkombëtare që bashkon institucione rregullatore, politikëbërës, ekspertë standardesh, përfaqësues të pacientëve dhe aktorë të industrisë. Diskutimet e samitit treguan se cannabis-i mjekësor në botë po trajtohet gjithnjë e më shumë si një sektor që lidhet me shëndetësinë, kërkimin shkencor, industrinë farmaceutike, industrinë ushqimore dhe zhvillimin e programeve universitare.



Megjithatë, mesazhi kryesor ishte i qartë: zhvillimi i këtij sektori mund të jetë i qëndrueshëm vetëm kur paraprihet nga standarde, kontroll, gjurmueshmëri dhe përgjegjësi publike. Për Shqipërinë, pjesëmarrja në këtë samit përforcoi një parim thelbësor: nuk është shpejtësia e hapjes së sektorit ajo që ndërton besim, por aftësia e shtetit për të vendosur rregulla të qarta, institucione të forta dhe mbikëqyrje të vazhdueshme. Në këtë kuptim, modeli që po ndërton Shqipëria nuk synon hapjen e një tregu të pakontrolluar, por krijimin e një sistemi ku çdo hallkë e aktivitetit të jetë e licencuar, e verifikueshme dhe e gjurmueshme. Vetëm kështu cannabis-i mjekësor mund të trajtohet si çështje shëndetësore, shkencore dhe rregullatore, jo si hapësirë për abuzim apo keqinterpretim.

[Lexo më shumë...](#)

SI DUKET EU-GMP NË PRAKTIKË: AGJENCIA VIZITON NJË NGA PRODHUESIT KRYESORË TË CANNABIS-IT MJEKËSOR NË RAJON | SHKUP, 27 PRILL 2026

Më 27 prill 2026, Drejtori i Përgjithshëm znj. Anila Alliu, së bashku me stafin e Agjencisë, zhvilloi një vizitë teknike në njësine e prodhimit të cannabis-it mjekësor të kompanisë PharmaRolly Holdings B.V. në Shkup të Maqedonisë së Veriut. Vizita u realizua pas kontakteve të vendosura gjatë Samitit Global Rregullator për Cannabis-in 2026 në Londër, ku CEO i kompanisë z. Stephen Malloy shprehu gatishmëri për bashkëpunim me Agjencinë dhe adresoi ftesën për një vizitë teknike.

PharmaRolly është aktive në Maqedoninë e Veriut që prej vitit 2019 dhe është certifikuar me standardin EU-GMP në korrik 2024. Kompania eksporton cannabis mjekësor në tregje si Gjermania, Zvicra dhe Mbretëria e Bashkuar, të cilat kërkojnë nivele të larta kontrolli, cilësie dhe përputhshmërie.

Gjatë vizitës, Drejtori i Përgjithshëm dhe stafi i Agjencisë u njohën nga afër me mënyrën e organizimit të zinxhirit të prodhimit, duke përfshirë kultivimin sipas standardeve GACP, sistemet e ekstraktimit, proceset e tharjes dhe ruajtjes, kontrollin e cilësisë dhe procedurat që lidhen me zbatimin e standardeve EU-GMP. Kjo vizitë kishte vlerë praktike për Shqipërinë, pasi tregoi se standardet ndërkombëtare nuk janë vetëm dokumente formale, por mënyrë pune në çdo fazë të aktivitetit: nga bima, te produkti, dokumentimi, kontrolli dhe eksporti.

Për Agjencinë, përvoja të tilla ndihmojnë në ndërtimin e një modeli mbikëqyrjeje që bazohet në realitetin operacional, në kontroll të vazhdueshëm dhe në gjurmueshmëri të plotë, në përputhje me ligjin nr. 61/2023.



"Falënderoj Steve Malloy për mikpritjen dhe mundësinë e vlefshme për të vizituar ambientet e certifikuara me EU-GMP në Shkup. Ky shkëmbim përvojash na ofroi një perspektivë mjaft praktike mbi standardet e larta, disiplinën dhe kontrollin operacional që nga kultivimi deri te sistemet e cilësisë, duke shërbyer si një model i shkëlqyer i funksionimit të cannabis-it mjekësor brenda një kuadri të rregulluar." - Anila Alliu, Drejtor i Përgjithshëm, AKKC

"Mirënjohës për këtë lloj bashkëpunimi ndërkufitar. Ndiemon industrinë të rritet dhe, më e rëndësishmja, përmirëson aksesin për pacientët." - Stephen Malloy, CEO, PharmaRolly Holding

Lexo më shumë...

ÇFARË MUND TË MËSOJË SHQIPËRIA NGA VENDI QË KA TRANSFORMUAR CANNABIS-IN MJEKËSOR NË SISTEM SHTETËROR | ROMË, 12 MAJ 2026



Vizita studimore në Romë, në kuadër të Programit TAIEX të Komisionit Evropian, i dha përfaqësuesve të Agjencisë një pasqyrë të detajuar mbi modelin institucional dhe rregullator italian për cannabis-in mjekësor. Gjatë takimeve në Ministrinë Italiane të Shëndetësisë, ekspertët e Ministrisë, UCS dhe AIFA prezantuan kuadrin ligjor që rregullon kultivimin, prodhimin, importin/eksportin dhe monitorimin e *cannabis*-it mjekësor, si dhe detyrimet që burojnë nga konventat ndërkombëtare dhe legjislacioni evropian.



Për Shqipërinë, mësimi kryesor është i drejtpërdrejtë: një sektor i ndjeshëm nuk mund të mbështetet vetëm te licencimi, por kërkon kontroll të vazhdueshëm, sisteme digjitale gjurmueshmërie, standarde të detyrueshme dhe ndarje të qartë të përgjegjësiive ndërmjet institucioneve.

Vëmendje e veçantë iu kushtua funksionimit të sistemit SIUCS për autorizimet dhe raportimin e substancave të kontrolluara, procedurave të importit dhe eksportit, raportimit pranë International Narcotics Control Board, si dhe modelit italian të inspektimeve GMP dhe mbikëqyrjes së bazuar në risk. Modeli italian dëshmon se ndërtimi i një sistemi funksional kërkon kohë, institucione të qarta dhe rregulla të zbatueshme. Në Itali, cannabis-i mjekësor trajtohet brenda një kuadri të kontrolluar, ku autorizimet, importi, eksporti, raportimi dhe gjurmueshmëria lidhen me sisteme të dedikuara dhe me detyrime ndërkombëtare.

[Lexo më shumë...](#)

BREDA FABRIKËS QË PRODHON PRODUKTE TË CANNABIS-IT PËR QËLLIME MJEKËSORE NË FIRENCE: NJË VIZITË NË STABILIMENTIN KIMIKO-FARMACEUTIK USHTARAK | FIRENCE, 13 MAJ 2026



Brenda Stabilimentit Kimiko-Farmaceutik Ushtarak të Firences (SCFM), institucion historik i themeluar në vitin 1832 dhe sot i autorizuar për prodhimin e cannabis-it mjekësor në Itali, përfaqësues të Agjencisë u njohën me mënyrën se si funksionon një zinxhir i kontrolluar prodhimi: kultivimi hidroponik, monitorimi në kohë reale i parametrave, identifikimi i serive të prodhimit, gjurmueshmëria e bimëve, tharja, ruajtja, laboratorët dhe prodhimi i lëndës vepruese farmaceutike sipas standardeve GMP.

Një rëndësi e veçantë iu kushtua masave të sigurisë fizike dhe kontrollit të aksesit. Ky element është thelbësor për një sektor ku mbrojtja nga devijimi dhe dokumentimi i çdo procesi janë po aq të rëndësishme sa vetë prodhimi. Vizita krijoi gjithashtu bazën për bashkëpunim teknik me SCFM në fushën e analizave laboratorike. Institucioni shprehu gatishmërinë për të analizuar mostra të *cannabis*-it nga Shqipëria, pas formalizimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet palëve.

Vizita në Firenze konfirmoi se cannabis-i mjekësor, kur trajtohet si produkt farmaceutik dhe substancë e kontrolluar, kërkon disiplinë institucionale, standarde të larta, laboratorë të besueshëm, sisteme kontrolli dhe përgjegjësi të plotë publike. Kjo është edhe logjika mbi të cilën Agjencia po ndërton rolin e saj në Shqipëri.

[Lexo më shumë...](#)



STRATEGJIA KOMBËTARE PËR KONTROLLIN E DROGAVE 2026–2030 | TIRANË, 7 PRILL, 26 MAJ 2026

Më 7 prill 2026, Agjencia mori pjesë në takimin e parë të grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Kontrollin e Drogave 2026–2030, të ngritur me Urdhrin Nr. 42, datë 22.01.2026, të Ministres së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Grupi i punës përfshin përfaqësues nga 23 institucione shtetërore dhe ka për detyrë hartimin e analizës së situatës, draftimin e strategjisë dhe planit të veprimit, si dhe zhvillimin e konsultimeve me ekspertë dhe organizata ndërkombëtare.

Kontributi i Agjencisë në këtë proces lidhet me ekspertizën e saj në kontrollin dhe mbikëqyrjen e cannabis-it për qëllime mjekësore dhe industriale, veçanërisht në parandalimin e devijimit të produkteve të ligjshme drejt tregut të paligjshëm.

Kjo qasje është në përputhje me filozofinë e strategjisë: reduktimin e ofertës, reduktimin e kërkesës dhe reduktimin e dëmit, duke e trajtuar kontrollin e cannabis-it si pjesë të një politike më të gjerë publike për sigurinë, shëndetin dhe përgjegjësinë institucionale.


**Workshop-i për
politikat e drogave |
Tiranë, 26 maj 2026**



Më 26 maj 2026, në ambientet e GIZ në Tiranë, u mbajt workshopi kombëtar mbi politikat e drogave me përfaqësues të institucioneve shqiptare dhe partnerë europianë, me fokus hartimin e Strategjisë Kombëtare për Kontrollin e Drogave.

Aktiviteti u organizua nga GPD/GIZ, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Dita mbledhi prezantime nga DG-HOME dhe EUDA mbi standardet europiane, një sesion mbi të drejtat e njeriut në politikat e drogave, si dhe prezantime nga institucione vendase mbi gjendjen aktuale të të dhënave dhe tendencave. Instituti Trimbos moderoi diskutimin mbi strukturën e mundshme të strategjisë.

SHQIPËRIA NË CANNRA 2026 | OKLAHOMA CITY, 8-10 QERSHOR 2026



Përfaqësues të Agjencisë zhvilluan një vizitë studimore në laboratorin referencë të Oklahoma Medical Marijuana Authority (OMMA). Qëllimi i vizitës ishte njohja nga afër me kontrollin laboratorik, si një hallkë kyçe për besueshmërinë e sistemit rregullator dhe sigurinë e pacientëve.

Gjatë vizitës u prezantuan procedurat e menaxhimit të mostrave, organizimi i laboratorit dhe protokollet e brendshme të cilësisë. Vëmendje e veçantë iu kushtua pajisjeve instrumentale dhe analizave specifike për mikroorganizmat, metalet e rënda, pesticidet, tretësit e mbetur, mykotoksinat dhe profilin e kanabinoideve.

Për Agjencinë, një element me interes të veçantë ishte qasja ndaj monitorimit analitik të pesticideve. Infrastruktura laboratorike dhe organizimi i OMMA-s ofrojnë modele të vlefshme për ngritjen e kapaciteteve tona kombëtare dhe mbikëqyrjen e integritetit të tregut.



NGA KAMPIONI TE REZULTATI: SI TESTOHET CANNABIS-I NË OKLAHOMA? | OKLAHOMA CITY, 8 QERSHOR 2026



Përfaqësues të Agjencisë, të kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm, znj. Anila Alliu, morën pjesë në edicionin 2026 të CANRA External Stakeholder Meeting, aktivitet që mbledhi autoritete rregullatore, laboratorë referencë, institucione akademike dhe ekspertë të sektorit nga Shtetet e Bashkuara, Kanadaja, Australia, Zelanda e Re dhe Shqipëria. Gjatë sesioneve të punës u trajtuan zhvillimet më të fundit rregullatore, politike dhe shkencore në sektorin e cannabis-it mjekësor dhe industrial, me fokus ndryshimet në politikat federale amerikane, zhvillimin e sistemeve rregullatore, sigurinë e produkteve, dhe kërkimin shkencor.

Sesionet teknike iu kushtuan monitorimit të tregut, përdorimit të analizës së të dhënave për identifikimin e parregullsive laboratorike, zhvillimit të standardeve ndërkombëtare për produktet me bazë kanabinoidesh dhe mekanizmave të mbikëqyrjes së industrisë. Një vëmendje e veçantë iu kushtua gjithashtu zhvillimit të kapaciteteve profesionale dhe trajnimit të burimeve njerëzore.

Gjatë aktivitetit, u zhvilluan gjithashtu takime bilaterale me përfaqësues të autoriteteve rregullatore, universiteteve dhe industrisë, ku u diskutuan mundësitë për bashkëpunim në mbështetje të zhvillimit të kapaciteteve institucionale të Agjencisë.

[Lexo më shumë...](#)

TAKIM ME EUDA: DREJT STANDARDEVE EUROPIANE TË RAPORTIMIT PËR CANNABIS-IN | TIRANË, 23 QERSHOR 2026



Më 23 qershor 2026, pranë ambienteve të Agjencisë u zhvillua një takim me ekspertë të Agjencisë Europiane të Drogave (EUDA), në kuadër të misionit të EUDA pranë Observatorit Kombëtar të Drogave. U diskutua rëndësia e mbledhjes dhe analizës së të dhënave mbi cannabis-in në Shqipëri, si dhe mundësia për bashkëpunim të mëtejshëm në raportimin e të dhënave të sakta dhe të krahasueshme me standardet evropiane. Mes instrumenteve të EUDA-s me interes të veçantë për Agjencinë u përmendën European Web Survey on Drugs (EWSD), International Cannabis Cultivation Questionnaire (ICCCQ) dhe ESPAD (European School Survey Project on Alcohol and Other Drugs), modele që mund të shërbejnë si referencë për realitetin shqiptar.

NJIHUNI ME STAFIN E AGJENCISË



Ka përfunduar studimet në Farmaci pranë Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Përvoja e saj profesionale përfshin fushën rregullatore të barnave, farmakovigjilencën dhe kontributin në hartimin e akteve nënligjore.

Ina Spahiu

“Cannabis-i për qëllime mjekësore dhe industriale është një nga fushat më dinamike në zhvillim, ku kërkimi shkencor, inovacioni dhe kuadri rregullator janë të lidhur ngushtë. Të punoj pranë Agjencisë më jep mundësinë të ndjek nga afër zhvillimin e kësaj fushe dhe të jem pjesë e zbatimit të një kuadri rregullator që synon të garantojë standarde të larta, transparencë dhe harmonizim me praktikat më të mira ndërkombëtare.”



**Agjencia Kombëtare e
Kontrollit të Cannabis-it**



www.nacc.gov.al



info@nacc.gov.al



Rruga "Ibrahim Rugova", 5,
Kati 13, 1001, Tiranë